



**VENDIM**

**Nr. 2, Datë 16.01.2012**

**PËR  
MODIFIKIMIN E LICENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE ME SERI PM09SH, NR. 77, LESHUAR ME VENDIM TE  
BORDIT TE KOMISIONEREVE TE ERE-S NR. 23, DT. 25.03.2009  
PËR SHOQËRINË KESH SH.A**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.2, 2.3 dhe 2.5 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pika 2 gërma “c”, pika 4 gërmat “a” dhe “b”, 17 pika 3 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.01.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “KESH” sh.a për ndryshimin e liçensës Nr. 77, Seria PM09SH, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 23, datë 25.03.2009 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë "KESH" sh.a, plotëson kërkesat ligjore si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma “a”**: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës.
- **Neni 15, pika 4, gërma “b”**: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçense.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të modifikojë liçensën me nr. 77, Seria PM09SH, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 23, datë 25.03.2009 për shoqërinë “KESH” sha.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.